



**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 226, Datë 26.10.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENER TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 628 datë 03.10.2018, shoqëria “ENER TRADE” shpk, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 220, datë 11.10.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u publikua në media njoftimi me nr. 55/61 Prot., datë 11.10.2018. Po ashtu me shkresën nr. 628/2 Prot., datë 16.10.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 2, gërma “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), për shoqërinë “ENER TRADE” shpk.
- Subjekti me shkresën nr. 628/1 Prot., datë 15.10.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar cituar më sipër.
- Aplikimi i shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

**KRYETARI**

**PETRIT AHMETI**